



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 49

2000

Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

Udhëzim nr.5, datë 11.12.2000	Për kalimin këshillave të qarqeve të ambienteve të punës, pajisjeve dhe numrit të punonjësve të ish-këshillave të rretheve.....	2109
Udhëzim nr.6, datë 11.12.2000	Për caktimin e strukturës organizative dhe organikës së administratës së këshillit të qarkut.....	2111
Vendim i KM, nr.726 datë 21.12.2000	Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.....	2113
	Kërkesë për shpallje të zhdukur të Maliq Groshi.....	2145
	Kërkesë për shpallje të zhdukur të Murat Çepaj	2145
	Vendim për shpallje të vdekur të Xhemal Shahini.....	2146

UDHËZIM
Nr.5, datë 11.12.2000

**PËR KALIMIN KËSHILLAVE TË QARQEVE TË AMBIENTEVE TË PUNËS, PAJISJEVE
DHE NUMRIT TË PUNONJËSVE TË ISH-KËSHILLAVE TË RRETHEVE**

Me konstituimin e këshillave të qarqeve, del e nevojshme të krijohen mundësitë që të funksionojë edhe administrata në shërbim të tyre. Mbështetur në nenin 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës, nenit 74 pika 1, nenit 75 dhe të nenit 54 pika “d” të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153 datë 3.4.1993 “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”,

U D H Ë Z O J:

I. Për zyrat e ish-këshillave të rretheve qendër qarku.

1. Deri në përcaktimin me ligj të një zgjidhjeje tjetër nga ish-administrata e këshillave të rretheve qendër qarku, do të vazhdojnë të qëndrojnë nën administrimin e prefektit seksionet apo zyrat, pajisjet sipas inventarit të fundit të muajit shtator 2000 si dhe numri përkatës i punonjësve si vijon:

- komisioni i kthimit të pronave ish-pronarëve,
 - zyrat e gjendjes civile,
 - seksioni apo zyra e kadastrës,
 - inspektori i MCR-së, dhe rojet e vendkomandave,
 - zyra e arkivit të rrethit.
 - Zyra e seksionit të financës, përgjegjësit e administratës, të protokollit, dhe magazinat të cilat mbahen në administrim të prefektit deri në realizimin e kalimit të aktivitetit dhe mbylljen e bilancit të vitit 2000, e më pas i kalojnë këshillit të qarkut.
2. Nuk do të lëvizin nga zyrat që kanë aktualisht në ambientet e ish-këshillave të rretheve:
- zyrat e regjistrimit të pasurisë,
 - zyrat e statistikës,
 - zyrat e kontrollit të mjeteve matëse,
 - zyrat rajonale të mbrojtjes së mjedisit,
 - dhe ndonjë zyrë tjetër me varësi nga qendra.

3. Për të gjitha zyrat e tjera që mund të jenë dhënë me qera nga ish-këshilli i rrethit, do të vazhdojnë të zbatohen kontratat ekzistuese deri në fund të vitit nëse këto zyra i nevojiten këshillit të qarkut, ndërsa për rastet e tjera nuk do të përsëritet asnjë kontratë, pa dalë një akt i ri i Këshillit të Ministrave që është në proces miratimi.

4. Zyra e ish-kryetarit, ish-zëvendëskryetarit dhe ish-sekretarit të këshillit të rrethit, salla e mbledhjeve të këshillit dhe zyrat e tjera, së bashku me pajisjet që kanë në inventarin e kryer në fund të muajit shtator 2000 (veç atyre të përmendura në pikën 1 të kësaj shkrese), me procesverbal të rregullt të hartuar midis prefektit dhe kryetarit të këshillit të qarkut, kalojnë në administrim të këshillit të qarkut duke bërë një marrëveshje me Kryetarin e këshillit të qarkut, lëvizjen e disa zyrave nëpër kate me qëllim që qarku të ketë 1 ose më shumë kate dhe administrata tjetër që mbetet të jetë në një ose më shumë kate, nëse do të jetë e mundur të realizohet edhe hyrja më vehte e çdo institucioni.

5. Këshillit të qarkut menjëherë

t'i kalohen edhe dy autovetura dhe 2 shoferë, nga kontigjenti që ka patur në inventar ish-këshilli i rrethit qendër qarku.

II. Për zyrat e ish-këshillave të rretheve që nuk janë qendër qarku.

1. Të mbeten në administrim të prefektit zyrat e:

- komisionit të kthimit të pronave ish-pronarëve,
- gjendjes civile,
- kadastrës,
- inspektorit të MCR-së, dhe rojet e vendkomandave,
- arkivit të rrethit,
- seksionit të financës,
- përgjegjësit të administratës,
- protokollit,
- sekretarit të deputetit ose deputetëve të zonës apo zonave elektorale,
- magazina.

2. Për zyrat që mund të mbeten të lira, pas kalimit të bërë si më lart, prefekti bën propozimin në Ministrinë e Pushtetit Lokal, për t'ia kaluar bashkisë qendër rrethi.

3. Në rastet e propozimeve nga bashkitë qendër rrethi për këmbimin e zyrave dhe kalimin e aktiviteteve nga bashkia në ambientet e ish-këshillit të rrethit dhe e kundërta, nga prefekti të bëhen propozimet konkrete në Ministrinë e Pushtetit Lokal për t'i miratuar, me kusht që të dy institucionet të kenë mundësinë që të kryejnë normalisht funksionet e detyrat që u ngarkohen.

4. Nga autoveturat që kanë patur ish-këshillat e rretheve jo qendër qarku, një prej tyre të mbahet në punë për pjesën e administratës që i mbetet në administrim prefektit në këto rrethe dhe rrethet qendër qarku, dhe për pjesën tjetër që mund të mbetet, të na bëhen propozimet për t'i kaluar në bashkitë apo komunat që nuk kanë autovetura, ose kur vlerësohen e domosdoshme edhe në këshillat e qarqeve.

III. Për punonjësit e administratës së ish-këshillave të rretheve.

1. Zyrat që mbeten në administrim të prefektit, do të shoqërohen edhe me numrin e punonjësve që aktualisht kanë në to. Nëse prefekti bën riorganizim administrativ, veçanërisht në rrethet qendër qarku duke mbuluar ndonjë shërbim me administratën e vet, mund të bëhen shkurtime duke vepruar sipas rregullave të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

2. Punonjësve që janë në seksionet apo zyrat, funksioni i të cilave i kalon këshillit të qarkut, t'u jepet leja e zakonshme për vitin 2000 (nëse nuk e kanë përdorur), të njoftohen që të konkurojnë në vendet e lira të punës që do të shpallë këshilli i qarkut, dhe nëse nuk do të fitojnë konkursin, për ta të zbatohet neni 23 i ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

3. Punonjësit e seksioneve dhe zyrave që u ndërpritet aktiviteti, do të mbahen në punë deri në emërimin e nëpunësve të strukturë-organikës së këshillit të qarkut, duke iu komunikuar menjëherë që të konkurojnë për vendet e punës, që do të shpallen për konkurim nga këshilli i qarkut, nëse dëshirojnë të punojnë në atë administratë. Nëse nuk konkurojnë ose nuk fitojnë vendin e punës pas konkurimit, ata i dorëzojnë detyrën dhe pajisjet që kanë në inventar këshillit të qarkut, u jepet leja e zakonshme e vitit 2000 (nëse nuk e kanë konsumuar atë), dhe ndaj tyre zbatohet neni 23 i ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

4. Në rast mosmarrëveshesh gjatë zbatimit të këtij udhëzimi, rrugëzgjdhjet do të përcaktohen nga Ministria e Pushtetit Lokal.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

UDHËZIM Nr.6, datë 11.12.2000

PËR CAKTIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE DHE ORGANIKËS SË ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT TË QARKUT

Me përfundimin e konstituimit të këshillave të qarqeve për hartimin e strukturës organizative

dhe organikës së administratës së këshillit të qarkut, në mbështetje të nenin 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës, nenit 74 pika 1, nenit 75 dhe nenit 54 pika “d” të ligjit nr.8652 datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”,

U D H Ë Z O J:

- Se miratimi i strukturës organizative dhe organikës së administratës së këshillit të qarkut është kompetencë e këshillit të qarkut.
- Për realizimin e kësaj kompetence të ndiqet kjo procedurë:

1. Ministria e Pushtetit Lokal, në mbështetje të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 5 të ligjit nr.7776 datë 22.12.1993 “Për buxhetin lokal”, me ndryshime nga Ministria e Financave, çel llogarinë e këshillit të qarkut dhe i dërgon atij treguesin e fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore, si dhe strukturën orientuese (bashkëlidhur) që i rekomandohet këshillit të qarkut për ndërtimin e administratës së vet.

2. Mbështetur në këta tregues, mundësitë që ka vetë këshilli i qarkut që nga të ardhurat e veta të përdorë një pjesë të tyre për këtë qëllim, si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992 “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore” me ndryshimet përkatëse, kryetari i këshillit të qarkut në bashkëpunim me zëvendëskryetarin e këshillit, hartojnë projekt-strukturën organizative, organikën me emërtimin e detyrave sipas klasave që përcaktojnë pagën bazë mujore dhe shtesën për funksion; pasi e shqyrton këtë material në kryesinë e këshillit të qarkut, ia paraqet për miratim këshillit të qarkut.

3. Mbështetur në vendimin e këshillit të qarkut, si dhe në zbatim të nenit 60 pika “dh” të ligjit nr.8652 datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” kryetari emëron personelin e administratës, i cili për realizimin e kësaj detyre duhet të mbajë parasysht:

- Sipas ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, kreu III, përcaktohen vendet e punës që trajtohen sipas këtij ligji dhe emërimi i këtyre nëpunësve do të bëhet sipas kërkesave të nenit 10 të ligjit si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.231 datë 11.5.2000 “Për pranimin në shërbimin civil dhe periudhën e provës”.
- Në administratën e këshillit të qarkut, të tërhiqen për sa është e mundur nëpunës të specializuar dhe me përvojë të gjatë pune në administratën e pushtetit vendor. Në mënyrë të veçantë nga administratat e këshillave të rretheve të cilat suprimohen, ky kontigjent duhet të trajtohet sipas kërkesave të ligjit “Statusi i nëpunësit civil”, kreu i IV, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.342, datë 7.7.2000 “Për lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë të nëpunësve civilë”.
- Punonjësit e tjerë që nuk i nënshtrohen kërkesave të ligjit të sipërpërmendur emërohen direkt nga kryetari.

4. Urdhërat e kryetarit për emërimin e punonjësve si gjithë aktet e këshillit (vendimet dhe urdhëresat) brenda 7 ditësh nga dita e miratimit të tyre i dërgohen prefektit, i cili brenda 10 ditësh duhet të shprehet për ligjshmërinë e aktit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

STRUKTURA ORIENTUESE E APARATIT ADMINISTRATIV TË KËSHILLIT TË QARKUT

Nr.	NJËSIA STRUKTURORE	NR.PUNONJËSVE
1.	Kryetar	1
2.	Sekretar i kryetarit	1
3.	Zëvendëskryetar (qenia funksionar fakultative)	1
4.	Sekretar i Këshillit të qarkut	1
5.	Seksioni i prog. dhe Zhvillimit Rajonal	5
	Përgjegjës	1
	Spektori i programimit	2

	Sektori i zhvillimit (investimeve)	2
6.	Seksioni i shërbimeve rajonale	4
	Përgjegjës	1
	Specialiste	3
7.	Seksioni i Urbanistikës	5
	Përgjegjës	1
	Specialist	4
8.	Seksioni i financës	3
	Përgjegjës	1
	Specialist	2
9.	Seksioni juridik dhe i marrëdhënieve me jashtë	3
	Përgjegjës	1
	Specialist	2
10.	Seksioni i personelit dhe i shërbimeve	10
	Përgjegjës	1
	Specialist	1
	Operator	1
	Protokoll-arkive	1
	Shoferë	3
	Pastruese	1
	Magaznier	1
	Roje operative	1
11.	Zyra e emergjencave civile	1
	Numri i Përgjithshëm	35

V E N D I M
Nr. 726 datë 21.12.2000

PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pagat mujore të titullarëve për institucionet e larta shtetërore, institucionet e tjera qendrore dhe pagat e personave të barazuar me ta janë sipas Lidhjes I “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit” dhe Lidhjes II “Klasifikimi i pagave të punonjësve të administratës së lartë shtetërore, institucioneve qendrore dhe funksionarëve në pushtetin lokal”, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Numri i klasave, madhësia e pagës bazë mujore dhe shtesat mbi pagë për funksionin sipas grupeve për punonjësit e aparateve të organeve të larta shtetërore, të institucioneve të tjera qendrore, të organeve të pushtetit lokal dhe të institucioneve të tjera buxhetore e pjesërisht buxhetore në varësi të ministrive e të institucioneve të tjera qendrore janë përkatësisht sipas Lidhjeve Nr. II “Paga bazë sipas klasave”, II/M “Paga bazë sipas klasave për punonjësit e ministrive, institucioneve të tjera qendrore, ATSH, prefekturave dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar”, Lidhjes II/1 “Pagat bazë sipas klasave për punonjësit e shëndetësisë” dhe Lidhja II/A “Shtesat mbi pagë për funksionet drejtuese”, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Pagat mujore të punonjësve të Presidencës, të Kuvendit, të Këshillit të Ministrave, të

ministrive e të institucioneve të tjera qendrore janë sipas lidhjeve Nr. II-1, II-3, II-4, II-4/1, II-4/2, II-4/3, II-4/5, II-4/7, II-5, II-5/1, II-8, II-9, II-10, II-11, II-12, II-13, II-14, II-15, II-16, II-17, II-18, II-19, II-20, II-21, II-22, të këtij vendimi.

3. Punonjësit e sistemit të shëndetësisë paguhen me lidhjen II/1 "Paga bazë sipas klasave për punonjësit e shëndetësisë".

Pagat e punonjësve të këshillave të qarqeve dhe të punonjësve të njëjësive bashkiake të Tiranës hyjnë në fuqi nga data e konstituimit të tyre, ndërsa paga e kryetarit të bashkisë së kategorisë së parë nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Pagat mujore të punonjësve të organeve të pushtetit lokal, të institucioneve buxhetore e pjesërisht buxhetore në varësi të ministrive e të institucioneve të tjera qendrore caktohen në bazë të numrit të klasave, madhësisë së pagës bazë dhe të shtesës mbi pagë, sipas lidhjes nr. II, II/1 dhe II-A që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale me titullarët e ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore caktojnë emërimet e detyrave, sipas klasave, dhe shtesën për funksion, sipas grupeve, për punonjësit e institucioneve të sistemit të tyre.

Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale me ministrin e Pushtetit Lokal caktojnë emërimet e detyrave, sipas klasave, dhe shtesën për funksion, sipas grupeve, për punonjësit e këshillave të qarqeve, të bashkive e të komunave.

Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale cakton emërimet e detyrave, sipas klasave dhe shtesën për funksion, sipas grupit, për emërtime dhe detyra të thjeshta të zbatueshme për të gjithë sektorët.

5. Punonjësit që marrin pagat sipas klasave të miratuara në lidhjen nr. II, II/1 dhe II/M të këtij vendimi, pas çdo viti pune, u jepet shtesë, për vjetërsi në punë 1 për qind mbi pagën bazë mujore, por jo më shumë se 25 për qind. Për llogaritjen e kësaj shtese njihet vjetërsia e përgjithshme në punë.

6. Titullarët e ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore, të organeve të pushtetit lokal, të institucioneve buxhetore e pjesërisht buxhetore, mbi bazën e pagave të caktuara në pikën 4 të këtij vendimi, caktojnë pagat bazë mujore dhe shtesat mbi pagë për punonjësit e tyre përkatësisht sipas emërtesave.

7. Për punë të vështirë e të dëmshme për shëndetin, punonjësve u jepen shtesa mbi pagën bazë mujore në masën që vijon:

- në shkallën e parë të vështirësisë e dëmshmërisë deri në 5%,
- në shkallën e dytë të vështirësisë e dëmshmërisë 10 deri 15%,
- në shkallën e tretë të vështirësisë e dëmshmërisë 15 deri 20%,
- në shkallën e katërt të vështirësisë e dëmshmërisë 20 deri 25%.

Këto shtesa, për të katër shkallët, llogariten mbi pagën bazë mujore të klasës së VI- të të lidhjeve përkatëse, kurse për punonjësit e repartit të Inspektim Minierave llogariten mbi pagën bazë mujore të klasës së XI-të të Lidhjes II "Paga bazë sipas klasave".

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale me Ministrinë e Shëndetësisë përcaktojnë kriteret për ndarjen e punëve sipas shkallëve të vështirësisë e të dëmshmërisë.

Punëdhënësit në bashkëpunim me drejtoritë e shëndetit publik ose me drejtoritë e higjenes dhe epidemiologjisë në rrethe, mbi bazën e kriterëve për ndarjen e punëve sipas shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë, studiojnë vendet e punës dhe profesionet e vështira e të dëmshme për shëndetin dhe i propozojnë ministrisë ose institucionit tjetër qendror të sistemit të tyre masën e shtesës mbi pagë në përqindje.

Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë miratojnë dhënien e këtyre shtesave për punonjësit e institucioneve dhe ndërmarrjeve buxhetore të sistemit të tyre.

Kur punonjësit i takon të marrë dy a më shumë shtesa për vështirësi a dëmshmëri, ai do të marrë nga një vështirësi për çdo shkallë.

Këto shtesa u rekomadohen edhe punëdhënësve të tjerë të ndërmarrjeve e institucioneve jobuxhetore shtetërore dhe private.

Punonjësit e sistemit të arsimit që i kanë përfituar këto shtesa deri më 1 Maj 1999 (me

miratimin e strukturës së re të pagave në arsim), do të vazhdojnë t'i përfitojnë ato derisa të qëndrojnë në atë vend pune. Punonjësit që fillojnë punë të re në arsim nuk i përfitojnë këto shtesa.

8. Mjekët që janë anëtarë të KMCAP (komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë në punë) eprorë dhe KMCAP në rrethe, për punën që bëjnë, marrin shpërblim në masën:

a- Për KMCAP epror dhe KMCAP-të e rretheve të grupit të parë, kryetari 36.5 për qind të pagës bazë mujore të mjekut dhe anëtarët 31 për qind të pagës bazë mujore të mjekut.

b- Për rrethet e tjera, kryetari 31 për qind dhe anëtarët 26 për qind të pagës bazë mujore të mjekut.

c- Punonjësit e ekspertizës mjekësore të punës, anëtarë të KMCAP marrin:

- Për KMCAP epror dhe për KMCAP-të e rretheve të grupit të parë, 15 deri 20 për qind të pagës sipas klasës që kanë.

- Për KMCAP e rretheve të tjera, 10-15 për qind të pagës sipas klasës që kanë.

Masa e shpërblimit caktohet nga drejtuesi i institucionit.

9. Mjekët që janë anëtarë të komisioneve mjeko-ligjore për punën që bëjnë marrin shpërblim në masën:

a- Për komisionet mjeko-ligjore të rretheve të grupit të parë, kryetari 17 për qind dhe anëtarët 15 për qind të pagës bazë mujore të mjekut.

b- Për rrethet e tjera, kryetari 15 për qind dhe anëtarët 12.5 për qind të pagës bazë mujore të mjekut në muaj.

10. Punonjësve, për kryerjen e shërbimit të rojës, të gadishmërisë dhe urgjencës në institucionet shëndetësore dhe punonjësve të repartit të inspektim-shpëtimit në miniera u jepet shpërblim si më poshtë:

a- Mjekëve që kryejnë shërbimin e rojës 24 orë pa ndërprerje në institucionet shëndetësore, u jepet për çdo shërbim roje një shpërblim 10 deri 20 për qind të pagës bazë mujore. Në raste të veçanta këtë shpërblim e përfitojnë edhe laborantet, kur është e nevojshme të kryejnë shërbim 24 orë.

b- Mjekut të qendrave shëndetësore ose të qyteteve të vogla të ngarkuar për të siguruar gadishmërinë e shërbimit shëndetësor gjatë 24 orëve, si dhe mjekut, infermierit e shoferit të urgjencës së rrethit, (që është i organizuar dhe funksionon si i tillë) dhe punonjësit e repartit të inspektim-shpëtimit në miniera, për kohën që qëndrojnë në gadishmëri, u jepet një shpërblim deri në 15 për qind të pagës bazë mujore.

c- Mjekëve dhe ndihmësve të tyre, kur për raste urgjente thirren pasdite ose natën nga mjeku i rojes së spitalit për veprime diagnostikuese a mjekuese, u jepet një shpërblim si më poshtë:

- Për konsultime në raste urgjente, pavarësisht nga numri i të sëmurëve që konsultohen ose kohëzgjatja e veprimit mjekues a diagnostikues, u jepet një shpërblim për çdo rast, me kusht që këto shpërblime të mos jenë më shumë se 20 për qind të pagës bazë për çdo muaj.

- Kur thirren pasdite ose natën në raste urgjente për ndërhyrje kirurgjikale, jepet një shpërblim për çdo rast, me kusht që këto shpërblime të mos jenë më shumë se 30 për qind të pagës bazë për çdo muaj.

ç- Ministria e Shëndetësisë për shtesa mbi pagë që përmenden në shkronjat "a", "b", "c", cakton kriteret, rregullat dhe vendet e punës për dhënien e shpërblimit.

11. Punonjësit e radiostacioneve të zonave të thella, mjekët dhe personeli i mesëm mjekësor që punojnë larg vendbanimit të tyre, marrin një shtesë mbi pagën bazë mujore si vijon:

a- Kur punojnë brenda rrethit të tyre, por larg vendbanimit, dhe kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre, deri në 10 për qind shtesë, kurse kur nuk kthehen në vendbanimin e tyre brenda ditës, deri në 30 për qind shtesë dhe kur punojnë në zonën e Dukagjinit e të Shllakut 50 për qind.

b- Kur emërohen jashtë rrethit të tyre, me afat kthimi:

- në rrethet Pukë, Tropojë, Kukës, Has, Malësi e Madhe, Dibër, Bulqizë, deri në 40 për qind, kur punojnë në qytet e në qendrën e rrethit, dhe deri në 50 për qind kur punojnë jashtë qytetit dhe qendrës së rrethit.

- në rrethet Mat, Mirditë, Gramsh, Librazhd deri në 300 për qind kur punojnë në qytet e në qendrën e rrethit dhe deri në 40 për qind nëse punojnë jashtë qendrës së rrethit.

- në rrethet e tjera deri në 20 për qind kur punojnë në qytet e në qendrën e rrethit dhe deri

në 30 për qind kur punojnë jashtë qytetit e qendrës së rrethit.

Drejtoria e Përgjithshme e RTV dhe Ministria e Shëndetësisë lëshojnë udhëzim për dhënien këtyre shtetasve.

12. Punonjësve të jashtëm që japin mësim në shkollat e larta, për çdo orë mësimi u jepet 286 lekë.

13. Punonjësit e jashtëm inxhinierë, ekonomistë, agronomë, etj., që japin mësim në shkollat e mesme, në shkollat e ulëta profesionale dhe në kurset e ndryshme (me përjashtim të kurseve që ngrihen pranë shkollave të larta, Institutit Pedagogjik dhe Drejtorisë së kualifikimit të kuadrit të arsimit), për çdo orë mësimore u jepet 160 lekë.

14. Punonjësit e institucioneve e të organizatave ekonomike qendrore e jo qendrore, për të cilët bëhet fjalë në pikën 13, për mësimet që japin brenda kohës normale të punës në kurset e kualifikimit që organizohen nga institucionet e tyre përkatëse, nuk shpërblehen kur orët e mësimi janë të barabarta me normën e arsimit për të njëjtën lëndë. Për orët suplementare paguhen sipas pikës 13.

15. Kuadri drejtues dhe instruktor efektiv në kurset e ndryshme, me përjashtim të kurseve që ngrihen pranë shkollave të larta, trajtohet për efekt page si drejtuesit dhe mësuesit e shkollave të mesme.

16. Kuadri drejtues në shkollat e ulëta profesionale trajtohet për efekt page si drejtuesit e shkollave të mesme.

17. Punonjësit mësimorë, që për nevoja të procesit mësimor japin orë mësimi mbi normën mësimore vjetore (të lejuar me dispozitë), paguhen për çdo orë mësimore:

- në shkollat e larta 286 lekë
- në shkollat e mesme 160 lekë
- në shkollat 8-vjeçare 132 lekë

18. Për nevojat e domosdoshme të fazës së projektimit dhe implementimit të rrjetit të telefonisë mobile, lejohet të aktivizohen edhe specialistë të profilizuar, që janë efektivë në shkollat e larta ose në institucione të tjera buxhetore. Këta specialistë të paguhen me pagën e specialistit të njësisë së implementimit të projektit mobil në varësi të orëve efektive të punës.

19. Për punonjësit efektivë, pedagogjiko-shkencore e kërkimore, të shkollave të larta dhe të instituteve kërkimore-shkencore, paga bazë mujore është si vijon:

- Akademik.....45 980 lekë
- Profesor. Drejtues kërkimesh37 510 lekë
- Profesor i asociuar. Mjeshër kërkimesh.....31 460 lekë

Kur këta punonjës caktohen në funksione drejtuese, përveç pagës përkatëse marrin edhe shtesën në përqindje mbi këtë pagë si vijon:

- Rektori i Universitetit të kategorisë I.....20
- Zëvendësrektor i Universitetit të kategorisë I
- Rektor i Universitetit të kategorisë II.....18
- Zëvendësrektor i Universitetit të kategorisë së II
- Drejtor instituti.
- Sekretar shkencor i seksionit në Akademinë e Shkencave.....17
- Dekan, Kancelar i Universitetit të Kategorisë së I..... 15
- Zëvendësdekan. Zëvendësrektor Instituti.
- Drejtor në Qendrën Kërkimore Shkencore.
- Kancelar në Universitetin e Kategorisë së II.....13
- Përgjegjës Departamenti.....12
- Përgjegjës qendre kërkimore. Përgjegjës shërbimi.
- Kancelar në fakultet.
- Kryetar seksioni në Akademinë e Shkencave.....10
- Përgjegjës seksioni. Përgjegjës klinike.
- Përgjegjës sektori.....8

- Punonjësit, që nuk janë efektivë në shkollat e larta ose në institutet kërkimore-shkencore, por janë bashkëpunëtorë në veprimtarinë e tyre, si dhe punonjësit efektivë të shkollave të larta që

nuk janë punonjës pedagogjikë (janë nëpunës) u jepet shpërblimi mujor si vijon:

- Për emërtesën Profesor ose Drejtues kërkimesh.....4 840 lekë
- Për emërtesën Profesor i asociuar ose mjeshtër kërkimesh.....4 235 lekë
- Për gradën shkencore Doktor i shkencave.....3 630 lekë

20. Punonjësve civilë që punojnë në sistemin e ushtrisë, u jepet deri në 20 për qind shtesë mbi pagën bazë mujore, në raste të veçanta dhe kur puna e tyre lidhet me gadishmërinë ushtarake. Kurse për punonjësit civilë në sistemin e Ministrisë së Rendit Publik, masa e kësaj shtese është deri në 50 për qind.

Punonjësve civilë të sistemit të burgjeve për natyrë të veçantë pune, u jepet deri në 70 për qind shtesë mbi pagën bazë mujore.

Titullarët e ministrive përkatëse caktojnë masën e shtesës për çdo vend pune.

21. Për natyrë të veçantë pune për mbajtjen në gadishmëri të ndriçimit të qytetit, punonjësve të ndërmarrjes së ndriçimit elektrik publik në Tiranë u jepet shpërblim 25-50 për qind të pagës bazë mujore.

22. Shoferi i Presidentit, i Kryetarit të Kuvendit dhe i Kryeministrit marrin pagën sipas klasës së VI-të të lidhjes II/M që i bashkëlidhet këtij vendimi.

- Shoferët e titullarëve të tjerë, të ministrave dhe të funksionarëve që përfshihen në klasifikimin A3, A4, A5, A6, A7 dhe A8, marrin pagën sipas klasës së V-të të lidhjes II/M që i bashkëlidhet këtij vendimi.

- Shoferët e tjerë të aparatit të Presidencës, të Kuvendit dhe të Këshillit të Ministrave marrin pagën sipas klasës së V-të të lidhjes II/M që i bashkëlidhet këtij vendimi, ndërsa shoferët e funksionarëve të tjerë që përmenden në klasifikimin A9, A10, A11, A12, B1, B2 dhe B3, marrin pagën sipas klasës IV të lidhjes II/M që i bashkëlidhet këtij vendimi.

23. Kryeministri dhe Zëvendëskryeministri mund të caktojnë këshilltarë të jashtëm, specialistë të shquar të fushavë të ndryshme, që kanë përvojë pune, vendas ose të huaj.

Ministrat caktojnë deri në 3 këshilltarë të jashtëm, të cilët mund të zgjidhen prej specialistëve të shquar të fushave të ndryshme, që kanë përvojë pune.

Këshilltari i jashtëm, i cili nuk ka shtetësinë shqiptare caktohet nga ministri me miratim të Kryeministrit.

Këshilltari i jashtëm, mund të jetë honorifik, ose mund t'i jepet për punën që kryen, një shpërblim mujor deri në 40 për qind të pagës bazë mujore të këshilltarit të brendshëm të institucionit. Masa e shpërblimit caktohet nga titullari i institucionit.

24. Punonjësit shqiptarë që përfshihen në njësitë ose drejtoritë e zbatimit të projekteve, kredive e ndihmave që përfiton Republika e Shqipërisë nga institucione ndërkombëtare ose qeveri të vendeve të ndryshme, trajtohen me këto paga:

Për projektet me rëndësi të veçantë, drejtori i projektit njehsohet në pagë me klasifikimin A12. Rëndësia e projektit caktohet nga Kryeministri.

Për projekte të tjera drejtori njehsohet në pagë me drejtorët e drejtorive të përgjithshme në varësi të ministrive.

Në të dy rastet, punonjësit e tjerë njehsohen në pagë me funksionet analoge në aparatet e ministrive, dhe mbi pagën bazë përfitojnë një shtesë prej 20%.

25. Nëse del e nevojshme të ketë emërtesa të tjera, perdoret lidhja III-5/37 "Renditja e detyrave sipas klasave për profesione të njëjta në të gjithë sektorët" dhe pagat të caktohen sipas lidhjes II/M.

26. Vendimi nr. 393, datë 3.9.1992, i Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LIDHJA II-A

I. SHITESAT MBI PAGË PËR FUNKSIONE DREJTUESE

Nr. !	Grupi !	Përqindja e shpërblimit
1.	deri në 5	
2.	5 deri në 10	
3.	10 deri në 15	
4.	15 deri në 20	
5.	20 deri në 30	
6.	30 deri në 40	

II. SHITESA TË TJERA.

Për natyrë të veçantë pune u jepet shtesë mbi pagën bazë:

1. Drejtuesve dhe specialistëve të Drejtorisë së Thesarit në Ministrinë e Financave 40 për qind, drejtuesve dhe inspektorëve të degëve të buxhetit në rrethe dhe inspektorëve të buxhetit në ministritë dhe institucionet e tjera qendrore 30 për qind, drejtuesve dhe inspektorëve të seksioneve të zyrave të financës në rrehte, bashki e komuna 20 për qind.

- Punonjësve të Drejtorisë së Financimit të Huaj e të Borxhit të Jashtëm në Ministrinë e Financave 20 për qind.

- Drejtuesve dhe specialistëve të Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Bankave në Ministrinë e Financave 40 për qind.

- Përveç shtesave të sipërpërmendura, drejtuesit, specialistët dhe punonjësit e tjerë në sistemin e Ministrisë së Financave marrin edhe një shtesë për natyrë të veçantë pune deri në 30 për qind, sipas përcaktimit që do të bëjë ministri i Financave.

2. Mjekëve dhe specialistëve të tjerë të sistemit të shëndetësisë, të specializuar (të vërtetuar me dëshminë përkatëse) që punojnë në vendet e punës sipas përcaktimit të Ministrisë së Shëndetësisë, 10 për qind mbi pagën bazë të specialistit.

Mjekëve që punojnë në qendrat shëndetësore në komuna, larg vendbanimit të tyre u jepet një shtesë 35 për qind mbi pagën bazë si dhe një shtesë për transport 5-15 për qind mbi pagën bazë sipas distancave që përcaktohen nga Ministria e Shëndetësisë.

- Punonjësve, të cilët punojnë me të sëmurët psikikë me të meta mendore, u jepet shtesë në masën 15-20 për qind mbi pagën bazë mujore, sipas përcaktimit që do të bëjë Ministri i Shëndetësisë.

3. Punonjësve të kontroll-revizionit ekonomiko-financiar:

Në ministri dhe institucione të tjera qendrore drejtorit 10 për qind, shefit të sektorit dhe kryetarit të degës 20 për qind, revizorëve (Inspektor kontrolli) 25-35 për qind.

Në këshillat e rretheve, bashkitë e komunat, përgjegjësve 25 për qind dhe revizorëve (inspektor kontrolli) 35-40 për qind.

Në ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore buxhetore revizorët 20 për qind dhe drejtuesit e tyre 10 për qind.

4. Kryeinspektorit dhe inspektorëve sanitarë shtetërorë të Republikës; kryeinspektorëve, inspektorëve ndihmësinpektorëve sanitarë shtetërorë të rretheve ose të ngarkuar me këto funksione; epidemiologut dhe ndihmësepidemiologut në strukturat e Drejtorisë së Shëndetit Publik dhe Drejtorisë së Higjenës dhe Epidemiologjisë e Institutit të Higjenës dhe Epidemiologjisë në Tiranë deri në 20 për qind.

Me të njëjtat kritere të trajtohen edhe inspektorët e drejtuesit e tyre në Inspektoriatin e Ushqimit, të Veterinarisë të mbrojtjes së bimëve, të zooteknikës, të farërave dhe të peshkimit. Inspektorëve dhe punonjësve të peshkimit që punojnë në det me mjete lundruese t'u jepet 25 për

qind shtesë mbi pagën ditorë për çdo ditë lundrim.

5. Inspektorëve për Kontrollin Farmaceutik Shtetëror në Ministrinë e Shëndetësisë dhe në Qendrën Kombëtare të Kontrollit të Barnave 10 për qind dhe inspektorëve për kontrollin farmaceutik në rrethe 20 për qind.

Për caktimin e masës së shtesës mbi pagë, ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria Bujqësisë dhe Ushqimit të nxjerrë udhëzimin përkatës.

6. Inspektorëve të ruajtjes së mjedisit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit 10 për qind.

7. Inspektorëve të inspektoriatit hekurudhor që kryejnë funksione kontrolli dhe drejtuesve të tyre 20 për qind.

8. Specialistëve të Drejtorisë së Standardizimit dhe Cilësisë dhe Drejtorisë Kombëtare të Metrologjisë dhe Kalibrimit që kryejnë funksione kontrolli dhe drejtuesve të tyre në Drejtoritë e Përgjithshme 10 për qind, kurse inspektorëve dhe drejtuesve të degëve në rrethe 20 për qind.

9. Punonjësve të inspektimit të Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike dhe të Inspektoriatit Shtetëror të Punës, në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe në prefekturë:

Drejtuesit 10 për qind, shefit të sektorit 15 për qind dhe inspektorëve 25-35 për qind.

10. Shefi i sektorit dhe specialistët e Drejtorisë së Punësim-Pagave në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale marrin një shtesë për natyrë të veçantë pune në masën 30 për qind mbi pagën bazë.

11. Inspektorët dhe përgjegjësit e zyrës së tyre në prefektura 30-40 për qind.

12. Në degët e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit drejtuesit 30 për qind dhe inspektorët 40 për qind, në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit drejtuesit 20 për qind, inspektorët 40 për qind.

13. Specialistëve dhe drejtuesve të tyre në Ministrinë e Punëve të Jashtme 10 për qind.

14. Mjekët në Qendrën e Shërbimit Mjekësor (Klinika Qeveritare) deri në 20 për qind.

15. Punonjësve të repartit të inspektim-shpëtimit të minierave 20 për qind. Vendet e punës që përfitojnë këtë shtesë, caktohen nga Ministria e Punëve Publike dhe Privatizimit.

16. Shoferit të Presidentit, të Kryetarit të Kuvendit, të Kryeministrit, shoferëve të titullarëve të tjerë, të ministrive dhe të funksioneve që përfshihen në klasifikimin A3, A4, A5, A6 dhe A8 50 për qind.

Shoferëve të funksionarëve që përmenden në klasifikimin A9, A10, A11, A12, B1, B2 dhe B3 40 për qind.

Shoferëve të tjerë të aparatit të Presidencës, Kryesisë së Kuvendit dhe të Këshillit të Ministrave deri 30 për qind.

17. Inspektorëve të përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave 20 për qind.

18. Asistentëve të shkollave të larta 10-20 për qind sipas sasisë së leksioneve që japin.

19. Drejtuesit dhe specialistët e sistemit të Ministrisë së Drejtësisë marrin një shtesë për natyrë të veçantë pune deri 30 për qind mbi pagën bazë, sipas përcaktimit që do të bëjë ministri i Drejtësisë.

20. Drejtuesit dhe specialistët e Drejtorisë së Programimit dhe Koordinimit, Sekretari Shqiptar për Paktin e Stabilitetit, Drejtorisë së Vlerësimit të Programeve, Drejtorisë së Analizave Ekonomike dhe Tregtare, Drejtorisë Juridike e të Marrëveshjeve dhe Sekretarit të Përhershëm Shqiptar të Koordinimit në Ministrinë e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregëtisë 45 për qind, kurse drejtuesit dhe specialistët e tjerë në po këtë Ministri 20 për qind.

21. Punonjësit e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, për natyrë të veçantë pune përfitojnë shtesë mbi pagën bazë deri 20 për qind, sipas përcaktimit që do të bëjë drejtori i përgjithshëm.

22. Drejtuesit dhe Specialistët e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimi dhe të Administratës së Përgjithshme të Ndihmës, të cilët paguhen sipas Lidhjes II/M, marrin një shtesë për natyrë të veçantë, deri 30 për qind, sipas përcaktimit që do të bëjë Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale.

LIDHJA I

RENDITJA E FUNKSIONEVE SIPAS KLASIFIKIMIT

A1	President	145 200
A2	Kryeministër. Kryetar i Kuvendit.	133 100
A3	Zëvendëskryeministër. Zëvendëskryetar i Kuvendit.	102 850
A4	Ministër Kryetar i Akademisë së Shkencave.	96 800
A5	Deputet	90 750
A6	Kryetar i Komitetit të Zhvillimit të Turizmit. Kryetar i Komisionit të Shërbimit Civil.	84 700
A7	Sekretar i Përgjithshëm në Presidencë. Sekretar i përgjithshëm në Këshillin e Ministrave. Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit. Kancelar i Gjykatës së Lartë.	78 650
A8	Anëtar i Komisionit të Shërbimit Civil.	72 600
A9	Prefekt i Tiranës. Kryetar i Bashkisë së Tiranës.	66 550
A10	Shef Kabineti në Presidencë. Drejtor Kabineti në Këshillin e Ministrave. Shef Kabineti në Kuvend. Zëvendësministër. Kryetar i Komitetit të Shtetëror për Kontrollin e Figurave të Zyrtarëve.	64 350
A11	Këshilltar i Presidentit. Këshilltar i Kryeministrit. Këshilltar i Kryetarit të Kuvendit. Zëdhënës i Presidentit. Zëdhënës i Kryeministrit. Zëdhënës i Kryetarit të Kuvendit. Drejtor i Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ, në Këshillin e Ministrave.	62 920
A12	Sekretar i Përgjithshëm në ministri Prefekt. Drejtor i Përgjithshëm i RTV. Drejtor i ATSH. Drejtor i Departamentit të Administratës Publike. Ndihmës i Presidentit. Ndihmës i Kryeministrit. Këshilltar i Zëvendëskryeministrit. Kryetar i Agjencisë Kombëtare të Energjisë. Kryetar i Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve. Zëvendëskryetar i Komitetit të Zhvillimit të Turizmit. Kryetar i Komitetit Shtetëror për Kultet. Kryetar i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Zëvendëskryetar, Sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave.	61 710
B1	Grupi i parë i Drejtorëve të drejtorive (departamenteve) në varësi të Presidencës, Këshillit të Ministrave, Kuvendit. Drejtor Departamenti në Presidencë, në Këshillin e Ministrave, në Kuvend. Drejtor Departamenti në ministri. Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes. Këshilltar i Kryesisë së Kuvendit.	56 870
	Ndihmës i Zëvendëskryeministrit. Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve. Kryetar i Këshillit të Qarkut. Kryetar i Komitetit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Kryeregjistruer i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.	
B2	Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme në Ministri dhe në varësi të ministrive. Drejtor i Drejtorisë së Protokollit të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme	54 450

